

**UNITED
NATIONS**

United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Ligjislatura e dytë

Komisioni për Shëndetësi, Punë
dhe Mirëqenie Sociale
Nr. 31/2007

PROCESVE BAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 23. 10. 2007, në sallën N-225, në orën 11.00

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Flora Brovina, Fehmi Vula, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi

Morën pjesë

Muhamet Gjocaj nga MPMS

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë

1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar ,

Pasi nuk u dhanë vërejtje , u miratua.

Ilaz Pireva ia rikujtoi Komisionit se nuk ka marrë përgjigje nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale . lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratit e punës dhe i njëjti t'i kthehet propozuesit meqë nuk i plotëson kushtet. Kërkoj që me këtë propozimit të njoftohen anëtarët e Komisionit.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

2. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku, përshëndeti përfaqësuesin e Ministrisë për Punë dhe Mirëqeni Sociale dhe raportuesen ftoi të marrë fjalën .

Zahrije Jusufi kërkoj të vazhdohet sipas tabelës krahasuese. Ajo i paraqiti amendamentet si vijon

Preambula pjesa e parë riformulohet :

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të kreut 5.1 (j) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë,

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët **përkujdesjen**

Neni 2 paragrafi 1) Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore shqisore dhe të kombinuara konsiderohen fëmijët e moshës prej 0-18 vjeçar

Neni 2 paragrafi 5) “Përkrahje materiale” në të holla që administrohet nga MPMS-ja, për familjen me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme

Neni 2 paragrafi 12 Ekspertiza nënkupton procedurën e vërtetimit të llojit ,shkallës se dëmtimit fizik ,mendor ,shqisor apo të **kombinuar** .

Neni 2 paragrafi 14 fëmijë nënkupton çdo **person** nën moshën 18 vjeçare ,me përjashtim kur

Kreu III **titulli riformulohet “Komisioni vlerësues për procedimin e aftësisë se kufizuar të përhershme të fëmijëve”**

Neni 10 pas paragrafit pesë shtohet paragraf i ri. .”**Mjek specialist i psikiatrisë** “

Neni 16 paragrafi 3) mandati i Komisioneve për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme zgjat dy (2) vjet

Neni 18 paragrafi (3) Kërkesa nuk mund të paraqitet para se fëmija me aftësi të kufizuara të përhershme të ketë arritur moshën 1 vjeçare. hiqet

Ne hartimin e këtyre amendamenteve përveç raportueses kontribuon deputetët : Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Flora Brovina, Fehmi Vula, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi

Ndërkohë edhe deputetja Flora Brovina pati amendamentet. Lidhur me këto Komisioni u pajtua që në pauzën e seancës plenare t'i rishikojë dhe t'i i miratojë raportin me amendamentet duke i rekomanduar Kuvendit të Kosovës për miratimin e tyre.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për skemën e ndihmës sociale e ftoi raportuesen që ta marri fjalën.

Nafije Berisha lidhur me Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale shtoi se ndryshimet e ofruara nuk zgjedhin çështjet, prandaj do të ketë vështersi në zbatimin e tij. Ajo në mënyrë të qartë i shpjegoi ndryshimet e bëra nga Ministria e Punës që t'i zgjidhë çështjet por përkundrazi ,me këto i komplikon .Duke u bazuar në këto fakte dhe në pamundësinë e amendamentimin e tij , Komisionit i propozoi Projektligjin t'ia kethje propozuesit Qeverisë së Kosovës .

Muhamet Gjocaj nuk u pajtua me diskutimin e raportueses dhe shtoi se MPMS ka humbur shumë kohë dhe kërkoi të vazhdohet me procedimin e Projektligjit Kryetarja e falënderoi për punën e bërë dhe shtoi se lidhur me propozimin Komisioni do të votojë pasi të ketë numrin e nevojshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 13,30

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**